REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3378/8 prot. Datë 17.12.2024

**V E N D I M**

**Nr.1786/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 17.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Vendim për mbylljen e çështjes mbi pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operator ekonomik "Rej" SHPK në procedurën e prokurimit "E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-10913-06-24-2024, me objekt: "- Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47. km" me fond limit 191,331,834.08 lekë pa TVSH, me datë të mbylljes për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 30.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Rej" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Artyka II" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik "Rej" SHPK me NIPT J93711608Q dhe adresë: sheshi "Evropa" Pogradec

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar me adresë: "Rruga Sami Frashëri nr.33", Tiranë.

**Subjekt i interesuar**: Operatori ekonomik "Alb-Building" SHPK me NIPT J69102508C dhe adresë Tiranë, Njësia Bashkiake nr.9, Rruga "Asim Vokshi", ndërtesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016.

Operatori ekonomik "Artyka II" SHPK me NIPT K26625603U dhe adresë: Korçë, Bilisht, Rruga e Mirasit, Km. I, (pranë ish nyjes së inerteve), Bilisht.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.06.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-10913-06-24-2024, me objekt: "- Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47.5 km" me fond limit 191,331,834.08 lekë pa TVSH, me datë të mbylljes për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 30.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), në datën 30.09.2024 ka përfunduar shprehja e interesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datën 08.11.2024 ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi rezultatet e "short-listing" ku rezulton si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| - "Rej" SHPK | skualifikuar |
| - "Alb-Building" SHPK | kualifikuar |
| - "Artyka II" SHPK | kualifikuar |

II.4. Në datë 15.11.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/4798 dhe me nr. 3378/2024 prot., datë 18.11.2024 e operatorit ekonomik -"Rej" SHPK ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Rej" SHPK si dhe mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "Alb-Building" SHPK dhe "Artyka II" SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar konkretisht duke pretenduar: *"[....] Në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë: - situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të*

*legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*- kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit (nëse ka). Ndërsa referuar procesverbalit për argumentimin e kritereve të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri si më poshtë: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Sipas përqindjes së kërkuar për plotësimin e kriterit për disponimin e shërbimeve të ngjashme me masën 30 përqind të fondit limit që prokurohet, del se, që kriteri të konsiderohet i plotësuar duhet që operatorët ekonomikë të dorëzojnë dokumentacion sikurse është kërkuar në pikën 2.3.1 të kritereve për të dëshmuar shërbimet e ngjashme në masën 57.399.550 lekë. Për plotësimin e këtij kriteri operatori "Rej" sh.p.k ka paraqitur kontratat e shërbimeve dhe të punëve të realizuara gjatë 3 viteve të fundit si më poshtë: Kontratë nr. 9, datë 22.02.2024, me objekt: "Mirëmbajtje me performancë K/Zëmblak – Liqenas-D.Goricës-Rrëmbec-Plasë", shoqëruar me vërtetim realizimi nr. 280/1, datë 23.09.2024, me vlerë të realizuar 20.562.122 lekë me tvsh. Kontratë me Bashkinë Pogradec me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit të Pogradecit dhe Njësie Administrative" për periudhën nga data 01.01.2022 – 30.04.2024, realizuar në vlerën 267.428.511 lekë me tvsh. Kontratë me Bashkinë Berat dhe Formular Vlerësimi për kontratën me objekt: "Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshatit Lapërdha 1, Otllak, Orizaj, Bashkia Berat", në vlerën 437.990.401 lekë me TVSH. 30 përqind e kësaj vlerë është realizuar nga shoqëria Rej shpk. Kontrata ka përfunduar në datën 28.10.2021. Kontratë me Bashkinë Përmet dhe Formular Vlerësimi, për kontratën me objekt: "Ndricim publik në kuadër të projektit "Bashki me energji inteligjente" përfunduar në datën 23.10.2023, me vlerë 64.955.112 lekë me tvsh, nga e cila 50 përqind e kësaj vlerë është realizuar nga Rej shpk. Kontratë me Bashkinë Pogradec dhe Formular Vlerësimi për kontratën me objekt: "Lidhja e urës Zall-Torres me rrjetin rrugor – Ndërtimi i mbështetëses së mesit" përfunduar në datën 27.01.2022 me vlerë 5.697.972 lekë me tvsh.*

*Kontratë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Formular Vlerësimi për kontratën me objekt: "Rehabilitimi i Urës në Maliq dhe Portave / Pritave të Saj" përfunduar në datën 07.12.2022, me vlerë 34.467.294 lekë me tvsh. Konfirmim për realizim të suksesshëm kontratë lëshuar nga Bashkia Pogradec me nr. 861/1, datë 21.02.2022 "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit të Pogradecit dhe Njësie Administrative" për periudhën Janar 2021 – Dhjetor 2021, realizuar në shumën 113.922.702 lekë me tvsh. Kontratë nr. 9, datë 07.01.2022, me objekt: "Mirëmbajtje me performancë K/Zëmblak – Liqenas-D.Goricës-Rrëmbec-Plasë", shoqëruar me situacionet e miratuara nga Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane dhe me faturat tatimore tec do situacioni ne vlere totale te te gjithe sherbimit te realizuar deri ne daten 06.01.2024 ne masen 72.283.156 leke me tvsh. Kontratë me Bashkinë Pogradec dhe Formular Vlerësimi për kontratën "Rehabilitim i Rruges se Rodokalit" përfunduar në datën 24.05.2023, me vlere 53.961.987 leke me tvsh. Kontratë nr. 20, datë 28.01.2021, me objekt: "Mirëmbajtje me performancë K/Zëmblak – Liqenas-D.Goricës-Rrëmbec-Plasë",*

*shoqëruar me situacionet e miratuara nga Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane dhe me faturat tatimore tec do situacioni ne vlere totale te te gjithe sherbimit te realizuar deri ne daten 31.12.2021 ne masen 28.371.385 leke me tvsh. Kontratë me Bashkinë Pogradec dhe Formular Vlerësimi për kontratën "Ujesjellesi i Mokres Faza e I-rë" përfunduar në datën 15.08.2022, me vlere 122.662.190 leke me tvsh. Nisur nga vlerat e kontratave të realizuara gjatë tre viteve të fundit, vlera e tyre e tejkalon me disa fish 30 përqindëshin e kërkuar të kontratës objekt prokurimi. Referuar përmbajtjes së tyre, konstatojmë se në arsyet e skualifikimit që ka përdorur KVO shumë prej këtyre kontratave as nuk i ka konsideruar fare dhe për këtë arsye ka arritur në konkluzionin se kriteri për disponimin e shërbimeve të ngjashme nuk plotësohet nga ana jonë ! Së pari, duhet të bëjmë një sqarim se pavarsisht se kjo procedurë prokurimi është klasifikuar si një kontratë shërbimi, por nëse i referohemi zërave të preventivit do të shohim që kemi dhe zëra punimevesh e jo vetëm shërbimesh. Në këtë kontekst të gjitha kontratat e ngjashme të mësipërme të dorëzuara nga ana jonë për përmbushjen e këtij kriteri duhej të vlerësoheshin nga KVO duke u mbështetur në situacionet pjesore ose përfundimtare të tyre ku do të konstatohej me lehtësi që shumë zëra të kësaj kontrate që prokurohet do të gjendeshin në situacionet përfundimtare të këtyre kontratave të realizuara nga ana jonë. Së dyti, pavarsisht se autoriteti kontraktor në arsyet e skualifikimit përdor termin se mungojnë kontratat e ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, në vetvete dhe në kundërshtim me ato çfarë ne kemi dorëzuar del se i referohet termit mbi kontrata të njëjta e aspak të ngjashme?! Nëse do ti qëndronte strikt përcaktimit ligjor mbi interpretimin e kontratave të ngjashme nuk do të arrinte në përfundimin e gabuar se kriteri i pikës 2.3.1 nuk përmbushet nga ana jonë. Por i ka qëndruar "kokëfortë" mungesës së kontratave të njëjta! e kësisoj ka arritur në përfundimin për skualifikim. Së treti, komisioni i vlerësimit të ofertave ka përdorur për skualifikimin e operatorit tonë një kriter i cili nuk është parashikuar si i tillë në dokumentat e tenderit!!! Nëse shohim me kujdes arsyet e skualifikimit KVO pretendon se: "Kriteri konsiderohet i papërmbushur pasi nuk plotësohet vlera e shërbimit të ngjashëm. Të kërkuar në kriterin 2.3.1 (shërbim i ngjashëm 30% e fondit limit nga kjo 40 % rehabilitim e cila përmbushet dhe tejkalohet nga operatori ekonomik dhe 60 % mirëmbajtje rutinë e cila nuk përmbushet nga operatori ekonomik" Pra sikurse shikohet lehtësisht ndryshe është përcaktuar në kriterin e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik të DT-ve dhe ndryshe pretendon KVO se ekziston ky kriter !!! Referuar fjalë për fjalë përmbajtjes së kriterit të pikës 2.3.1 si dhe argumentimit të këtij kriteri të përcaktuar në procsverbalin e argumentimit të dokumentave konstatojmë se kërkohet që të dorëzohen dokumenta që provojnë kryrjen e shërbimeve të ngjashme në masën 30 përqind, por askund nuk është përcaktuar se ky 30 përqindësh duhet plotësuar në masën 40 përqind për punime rehabilitimi dhe 60 përqind për mirëmbajtje rutinë ! nuk ekziston askund një kriter i përcaktuar kështu, pavarsisht se edhe sipas kësaj ndarje që kërkon të bëjë KVO ne përsëri e plotësojmë kriterin e disponimit të shërbimeve të ngjashme. KVO pretendon se kriteri për të disponuar shërbime të ngjashme në masën 30 përqind të fondit limit, ndahet në 40 përqind i tij rehabilitim dhe 60 përqind mirëmbajtje rutinë !!! Ky pretendim shkon përtej asaj çfarë ka përcaktuar njësia e prokurimit në dokumentat e tenderit dhe KVO krijon një kriter nga hiçi vetëm e vetëm për të skualifikuar operatorin tonë ekonomik. Të nderuar anëtarë të KVO e KSHA nëse i referoheni specifikimeve teknike se si do të zbatohet kjo kontratë dhe për analogji ato i përdorni si kritere kualifikimi jeni plotësisht në shkelje të rregullave të prokurimit publik dhe shkeljes së barazisë mes operatorëve ekonomikë. Së katërti, kërkojmë që KSHA të marrë në konsideratë të gjitha kontratat, formularet e vlerësimit, situacionet e faturat e dorëzuara nga ana jonë për*

*përmbushjen e ketij kriteri, te realizuara gjatë tre viteve të fundit dhe ti ballafaqojë me zërat e sherbimeve dhe punimeve të kësaj kontrate që prokurohet, me qëllim arritjen e një përfundimi që operatori Rej shpk jo që e plotëson kriterin deri në masën 30 përqind të fondit limit por e tejklaon me disa herë atë. Gjithashtu në arsyen për skualifikim AK ka shprehur se : Shërbimi i ngjashëm K/Zëmblak – Liqenas e vitit 2024 është kontratë në proces, nuk ka përfunduar, afati i kësaj kontrate përfundon në datën 08.02.2025, kjo në kundërshtim me kriterin 2.3.1 ”Realizuar me sukses gjatë 3 viteve të fundit”, Pra, me këtë arsyetim nuk e ka konsideruar si punë të ngjashme, kjo bie ndesh dhe në kundërshtim me vendim të KPP nr. 157/2017 datë 23/03/2017 ku KPP ka arsyetuar: Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimin objekt prokurimi. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, KPP gjykon se ratio legis e nenit 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, është vërtetimi i eksperiencës së mëparshme të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Konkretisht KPP gjykon referuar aktit nënligjor në zbatim të ligjit, parashikohet strictu sensu se pranohen si dëshmi të ngjashme vërtetime ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe në asnjë rast lidhur me faktin se kontrata në tërësi duhet të ketë përfunduar. Gjithashtu, edhe në kriteret e veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar dorëzimin e shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare sa 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Në rastin konkrekt, KPP gjykon se në respekt të ligjit për prokurimin publik autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik vetëm për faktin se kontrata fillestare e shërbimit është në proces dhe e pa përfunduar, kur këto të fundit, me anë të dokumentacionit të dorëzuar provojnë për periudhën e deklaruar kanë kryer shërbim, shërbim i cili është përfunduar me sukses dhe pranuar nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit të hartuar nga autoriteti kontraktor, si edhe vetë parashikimeve të aktit nënligjor të zbatim të ligjit, KPP gjykon se në asnjë rast nuk parashikohet se operatorët ekonomikë, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme në kontratat e shërbimit publik duhet të dorëzojnë kontrata të përfunduara, por me anë të dokumentacionit duhet të dëshmojnë se kanë realizuar me sukses shërbime të përfunduara brenda 3 viteve të fundit, gjykimi i kufizuar vetëm mbi anën formale të kontratës në rast se kjo e fundit ka përfunduar ose jo , do të sillte rastin klasik të diskriminimit të operatorëve ekonomikë të cilët zotërojnë kontrata shumë vjeçare. KPP gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ankimuesi ka vërtetuar se ka kryer me sukses, shërbime të ngjashme mbi vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, ( 40 % të vlerës së fondit limit të kontratës së prokuruar). Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron. Duam ti rikujtojmë AK, se “REJ” sh.p.k ka aktualisht Kontratë për Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak-Liqenas Dog Goricë, Libonik-Rrëmbec -Plasë, për të cilën kemi lidhur kontratën që në datën 28/01/2021 dhe vazhdojmë dhe sot. Subjekti jonë paraqet çdo muaj të gjithë dokumentacionin për shërbimet dhe punimet e kryera të cilat janë certifikuar dhe certifikohen aktualisht edhe nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe po ashtu nga Drejtoritë e Rajoneve përkatëse. Kjo arsye skualifikimi është absurde pasi i njëjti AK ka paguar dhe paguan shërbimet e kryera dhe po vetë ky AK arrin në konkluzion se OE*

*REJ shpk nuk përmbush vlerën për punimet e ngjashme rutinë. Fakti që shërbimi është kryer, shoqëruar me situacion punimesh të konfirmuara nga mbikqyrësi dhe të paguara rregullisht nga AK, përbën një provë për realizimin e kontratës konform kërkesave të kontratës dhe specifikimeve teknike.*

*Së pesti, kërkojmë skualfikimin e operatorit ekonomik "Alb Building" sh.p.k pasi nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 dhe 2.3.5 të kapacitetit. Ky pretendim i yni për mosplotesimin e këtyre kritereve nga ky operator ekonomik, merr shkas nga arsyet e skualifikimit të këtij operatori ekonomik, për të cilën jemi njohur pas publikimit të Njoftimit të Fituesit për procedurën e prokurimit publik me objekt: "Loti 3: Mirëmbajtje me performancë "Tiranë - Linzë- Qafë Priskë, Qafë Priskë -Qafë Mollë, Trau Dajt - Kamp, Kryq. Dajt - Vila Qeveritare, Rot. TEG – Ibë, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Arbanë –Vishaj", (64.1 km), me fond limit 202,154,683.34 (dyqind e dy milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pike tridhjetë e katër) Lekë pa TVSH, me nr. REF-10978-06-24-2024", nga ku rezulton se subjekti Alb Building shpk është skualifikuar më arsyet si më poshtë: Skualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve te nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet standarde te tenderit. Operatori ekonomik "ALB BUILDING" sh.p.k. nuk përmbush kriterin 2.3.4 "Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt". Operatori ekonomik "ALB BUILDING" sh.p.k. nuk përmbush kriterin 2.3.5 "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë),. " Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. Drejtuesi teknik si dhe personeli kryesor i shërbimeve/punimeve (inxhinier topograf/gjeodet) i deklaruar nga OE janë të angazhuar ne Kontratën me objekt "Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafë Thanë, (Faza I)." Kriteri konsiderohet i papërmbushur nga operatori ekonomik. Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertë ekonomik apo ka marrë pjesë në më tepër se një lot për këto procedura të zhvilluara nga autoriteti rrugor shqiptar dhe për këtë arsye ai nuk disponon një inxhinier ndërtimi, një topograf dhe një mekanik, pasi i ka të anagazhuara në kontrata të tjera dhe i ka të deklaraura pranë ARRSH në më shumë se një lot pjesëmarrjeje. Gjithashtu, ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 2. 3.7 dhe 2.3.9. Në kriterin 2.3.7 kërkohet që operatorët ekonomik të disponojnë minimalisht 8 manovratorë. Operatori Alb Building shpk ka marrë pjesë në më shumë se një lot pranë ARRSH dhe nuk disponon numrin e manovratorëve të marrë së bashku në mënyrë kumulative. Gjithashtu dhe për makineritë dhe pajisjet e tjera të kërkuara në kriterin e pikës 2.3.9, ky operator nuk plotëson numrin e makinerive të marra së bashku në secilin prej loteve ku ma marrë pjësë, për këto arsye kërkojmë skualifikimin e këtij operatori ekonomik.*

*Në fund të kritereve të kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë: "Shënim 1: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpika 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret.*

*Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet per kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar. Nisur nga këto përcaktime, referuar faktit që ky operator ekonomik ka marrë pjesë në më shumë se një lot, nuk plotëson kriteret e pikave 2.3.4, 2.3.5, 2.3.7 dhe 2.3.9 të kapacitetit teknik e për këto arsye duhet të skualifikohet. Në pikën 2.3.6 të modifikuar kërkohet që: 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik, 1 (një) inxhinier Mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë), 1 (një) inxhinier Elektrik, Me dokumentacionin e dorëzuar operatori Alb Building shpk nuk e plotëson këtë kriter pasi nuk disponon një inxhinier Mjedisi i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik. Mos plotësimi i këtij kriteri i cili është modifikuar në zbatim të vendimit të KPP-së lidhur me trajtimin për ankesat për kriteret e kualifikimit, përbën kusht për skualifikimin e këtij operatori ekonomik. Së gjashti, kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik "Artyka II" sh.p.k për mos plotësimin e kriterit të pikës 2.2.1, i cili përcakton se: 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit). Me dokumentacionin e dorëzuar subjekti Artyka II shpk nuk provon se plotëson xhiron vjetore të një vit inga tret ë fundit në masën 100 përqind të fondit limit të prokurohet. Operatori ekonomik Artyka II shpk duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.1, pasi nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sic përcakton kriteri 2.3.1 për të provuar disponimin e shërbimeve të ngjashme në masën 30 përqind të fondit limit që prokurohet. Ky pretendim i yni buron nga fakti se referuar të dhënave të 4 viteve të fundit lidhur me zbatimin e kontratave me këtë objekt me ARRSH, ky operator ekonomik, nuk ka marrë kontrata në atë masë që të justifikojë përmbushjen e kriterit, gjithashtu dhe kontrata e fundit e lidhur me ARRSH është kontratë në proces dhe si rregull barazie KVO nuk mund ta përfshinte në totalin e shërbimeve të ngjashme. Edhe në hipotezën e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi, me një ose disa operatorë të tjerë (informacion që fatkeqësisht ne s'mund ta dimë në këtë fazë të procedurës) përsëri ky kriter nuk plotësohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP" të ndryshuar, e cila parashikon se në rastin e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat p?r kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Operatori ekonomik Artyka II shpk duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 dhe 2.3.5, të cilat përcaktojnë se: [...2.3.4 Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 11. "Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe*

*CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor(jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë: 1 (një) inxhinier Topograf, 1 (një) inxhinier Mekanik, *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 11. "Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese". Për secilin pjesëtar të stafit ndihmës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*
*Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. Lidhur me plotësimin e këtyre dy pikave rezulton se ky operator disponon vetëm një inxhinier ndërtimi dhe atë e ka të deklaruar në kontrata të tjera që ushtron veprimtarinë e tij, ndërsa sa i përket kriterit të pikës 2.3.5 operatori ekonomik Artyka II shpk nuk disponon një inxhinier topograf. Edhe në hipotezën e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi, me një ose disa operatorë të tjerë (informacion që fatkeqësisht ne s'mund ta dimë në këtë fazë të procedurës) përsëri ky kriter nuk plotësohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP" të ndryshuar, e cila parashikon se në rastin e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Operatori Artyka II shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.6 të kapacitetit teknik të modifikuar, në të cilën kërkohet që: 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik, 1 (një) inxhinier Mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë), 1 (një) inxhinier Elektrik, Me dokumentacionin e dorëzuar operatori Artyka II shpk nuk e plotëson këtë kriter pasi nuk disponon një inxhinier Mjedisi i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik. Mos plotësimi i këtij kriteri i cili është modifikuar në zbatim të vendimit të KPP-së lidhur me trajtimin për ankesat për kriteret e kualifikimit, përbën kusht për skualifikimin e këtij operatori ekonomik. Edhe në hipotezën e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi, me një ose disa operatorë të tjerë (informacion që fatkeqësisht ne s'mund ta dimë në këtë fazë të procedurës) përsëri ky kriter nuk plotësohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP" të ndryshuar, e cila parashikon se në rastin e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat p?r kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Operatori ekonomik Artyka II shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.7 pasi nuk disponon me dokumentacionin e kërkuar numrin e 8 manovratorëve të kërkuar në këtë kriter, duke mos përmbushur në këtë mënyrë*

*kriterin e kërkuar që përbën shkak për skualifikim. Edhe në hipotezën e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi, me një ose disa operatorë të tjerë (informacion që fatkeqësisht ne s'mund ta dimë në këtë fazë të procedurës) përsëri ky kriter nuk plotësohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP" të ndryshuar, e cila parashikon se në rastin e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat p?r kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Operatori ekonomik Artyka shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.9 të kapacitetit teknik pasi nuk disponon 3 Mjete transporti vetëshkarkues mbi 8 ton, nuk disponon 3 Kamionçina deri në 3.5 ton, nuk disponon 2 Minieskavator, nuk disponon 2 Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent), nuk disponon 2 Ekskavator me goma si dhe nuk disponon 3 Borëpastruese (APV). Edhe në hipotezën e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi, me një ose disa operatorë të tjerë (informacion që fatkeqësisht ne s'mund ta dimë në këtë fazë të procedurës) përsëri ky kriter nuk plotësohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP" të ndryshuar, e cila parashikon se në rastin e pjesëmarrjes si Bashkim operatorësh, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Gjithashtu në përmbushje të detyrimit për të paraqitur të gjtihë dokumentacionin sipas vetëdeklarimit të bërë në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit, rezulton se operatori Artyka II shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion që provon se subjekti nuk është i dënuar më vendim të formës së prerë lidhur me veprimtarinë e tij, pra nuk është paraqitur Vërtetimi Gjendjes Gjyqësore të subjekti.*
*Operatori ekonomik Artyka II shpk nuk ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga furnizuesi i energjisë elektrike që të provojë se ka likujduar faturën e energjisë të maturuar, për të gjitha kontratat që ka të deklaruara në Republikën e Shqipërisë.*
*Nisur nga të gjitha këto pretendime kërkojmë skualifikimin e operatorit Artyka II shpk. Sa më sipër perfundimisht kërkojmë:*
*a-) Pranimin e ankesës*
*b-) Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit Rej shpk, duke e kualifikuar atë.*
*c-) Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e operatorëve Alb Building shpk dhe Artyka II shpk, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.*

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. prot 3378/2 date 18.11.2024, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK si dhe kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon, se nuk plotësohen nga operatorët ekonomikë “Alb-Building” SHPK dhe “Artyka II” SHPK.

II.6. Me datë 25.11.2024 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për trajtimin e ankesës i cili u protokollua me tonën me nr. 3378/3 prot., datë 25.11.2024, në të cilin konstatohet se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar:
*“ 1.Referuar pretendimit tuaj për plotësimin e kriterit në pikën 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës mbas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj për përmbushjen e këtij kriteri, arsyeton si më poshtë: Fillimisht duam të sqarojmë që kontrata në fjalë objekt i kësaj procedure - Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47.5 km, me vlerë totale 191,331,834.08 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë zero tetë) Lekë pa TVSH., është një kontratë shërbimi ku pjesa e shërbimeve të mirëmbajtjes rutinë prevalon mbi pjesën ndërtimore që i përket punimeve të rehabilitimit. Duke qenë një kontratë shërbimi detyrimisht duhet të përshtatet me punimet e ngjashme të këtij lloj shërbimi, pra “mirëmbajtje rutinë me performancë”, metodë e cila po aplikohet në Shqipëri për shumë vite në mirëmbajtjen e rrugëve, dhe bazohet mbi nivelet e shërbimit. Në Specifikimet Teknike, pjesë e rëndësishme e Dokumenteve të Tenderit janë të sqaruara shumë mirë ndarjet e shërbimeve me punimet ndërtimore në raportet rreth 60% me rreth 40%, ku citohet: *Mirëmbajtja e rrjetit rrugor përfshin detyrat e mirëmbajtjes rutinë dhe periodike. Mirëmbajtja rutinë konsiston në detyra që janë të nevojshme për të mirëmbajtur funksionimin e rrugës (siç janë riparimet e gropave, pastrimi i drenazhimeve, vulosja e plasaritjeve, prerja e vegjetacionit, etj.). Mirëmbajtja rehabilituese dhe periodike konsiston në masa me të kushtueshme të një natyre më pak të përdorshme në mënyrë që të parandalohet degradimi i rrugëve (siç është nivelimi, drenazhimet, rimbushjet, mbishtresat me asfalto – beton, ndërtimi i mureve mbajtës e pritës, plotësim me pajisjet mbrojtëse, plotësim me sinjalistikë, etj.) Këto punime janë punime me matje të cilat kryhen në periudha të ndryshme të kohëzgjatjes së kontratës sipas nevojave dhe kushteve atmosferike. Tepër të rëndësishme janë menaxhimi i kujdesshëm, afatet e ndërhyrjeve dhe saktësia e zgjidhjeve teknike… *2.2 Punimet e Rehabilitimit dhe Periodike për tu kryer. Punimet totale të rehabilitimit dhe periodike për tu kryer nuk duhet të kushtojnë me shumë se 40% të vlerës totale të kontratës. *2.2.1 Si shprehen punimet e rehabilitimit dhe periodike. Punimet e rehabilitimit janë punime të cilat do të kryhen me fillimin e kontratës, detyrimisht brenda vitit të parë,(në rastet kur kontrata është mbi 2 vite dhe në 6 muajt e parë kur kontrata zgjat më pak se 2 vite) për të sjellë rrugën në kushte të pranueshme, për fillimin e mirëmbajtjes sipas nivelit të përcaktuar për atë rrugë, ndërsa punimet periodike janë punime që do të kryhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës në periudha të favorshme nga moti. Këto punime zënë maksimalisht 40% të vlerës totale të kontratës… Etj, Konkretisht, referuar fondit limit prej 191,331,834.08 lekë pa tvsh, të kësaj kontrate përqindja e punimeve ndahet si më poshtë: -Për shërbimet/ punimet e mirëmbajtjes rutinë vlera është 113,673,960 lekë pa tvsh. -Për punimet e*

*rehabilitimit dhe periodike vlera është 72,085,102 lekë pa tvsh. -Për punimet e emergjencës vlera është 5,572,771 lekë pa tvsh. Për sa i përket plotësimit të kriterit te kërkuar ne piken 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë - situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. - kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit (nëse ka) Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka marrë në konsideratë të gjitha kontratat të paraqitura nga operatori "Rej" sh.p.k. në të cilat konstatojmë se nga ky operator është plotësuar vlera prej 40 % të punimeve të rehabilitimit. Ndërkohë referuar plotësimit të vlerës prej rreth 60% për punimet e mirëmbajtjes rutinë janë marrë në konsideratë të gjitha kontratat e ngjashme si më poshtë, nga të cilat konstatohet se: -Kontrata nr. 9, datë 22.02.2024 me objekt: Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak-LiqenasDogana Goricë-Rrëmbes-Plasë", nuk ka përfunduar dhe është në proces me Drejtorinë e Rajonit Qendër Lindje Korçë deri më datë 08.02.2025 siç specifikohet në kontratën e lidhur me DRQL Korçë dhe me vlerë 40,201,956 lekë me tvsh ( dhe jo përmbushje pjesore me vlerë 20,562,122 lekë me tvsh) Kjo kontratë nuk mund të klasifikohet si punë e ngjashme deri në momentin e plotë të përfundimit dhe përmbushjes (datë 08.02.2025) dhe shoqëria të pajiset me formularin e vlerësimit për përfundimin e plotë të kontratës siç specifikohet qarte ne DST: *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit... -Kontrata nr. 9 datë 07.01.2022 (për periudhën 2022-2024) me objekt : "Mirëmbajtje me performancë, Kryqëzim K/Zemblak-Liqenas-Dogana Goricë-Rrëmbes-Plasë". Duke qenë se nga ky operator nuk është paraqitur vërtetim i lëshuar për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit (formular vlerësimi) në përmbushje të plotë të kriterit të kërkuar në DST, për një vlerësim sa më të drejtë të kësaj ankese Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës kërkoj një konfirmim nga ana e Drejtorisë se Rajonit Qëndror Tiranë si Autoriteti Kontraktues i kësaj kontrate nëse kjo kontratë e lidhur midis operatorit ekonomik "Rej"shpk dhe Drejtorisë së Rajonit Qëndror Tiranë ishte e përmbushur nga operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës , mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të shoqërisë "Rej" sh.p.k për kontratën nr. 9 datë 07.01.2022 (për periudhën 2022- 2024) me objekt : "Mirëmbajtje me performancë, Kryqësim K/Zemblak-Liqenas-Dogana Goricë-Rrëmbes-Plasë", Drejtoria e Rajonit Qëndor Tiranë konfirmoi se kjo kontratë nuk është përmbushur nga operatori ekonomik "Rej"shpk. Për sa më sipër, kjo kontratë nuk mund të klasifikohet si punë e ngjashme deri në momentin e plotë të përfundimit dhe përmbushjes dhe shoqëria të pajiset me formularin e vlerësimit për përfundimin e plotë të kontratës siç specifikohet qarte ne DST: për përvojën e mëparshme të*

*realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit... Në vijim referuar kontratës tjetër të paraqitur nga operatori ekonomik "Rej"shpk., kontratë nr. 20 datë 28.01.2021 me objekt :"Mirëmbajtje me performancë, Kryqësim K/Zemblak-Liqenas Dogana Goricë-Rrëmbes-Plasë", vlera prej 60 % për punimet e mirëmbajtjes rutinë nuk plotësohet. Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se ky kriter nuk është përmbushur dhe pretendimi juaj nuk qëndron.*

*2. Lidhur me pretendimin për skualifikimin nga procedura për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit të operatorit ekonomik "Alb Building" sh.p.k" argumentojmë si më poshtë: Formulari i ankesës i paraqitur nga Operatori Ekonomik "REJ" sh.p.k, pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, është plotësuar për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47.5 km, me vlerë totale 191,331,834.08 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë zero tetë) Lekë pa TVSH dhe REF 10913-06-24-2024 dhe si i tillë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm për shqyrtimin e ankesës, shqyrton këtë procedurë prokurimi dhe jo procedura të tjera (të zhvilluara në kohë dhe në kushte të ndryshme) të cilat nuk janë plotësuar në Formularin e Ankesave dhe nuk janë objekte ankimimi. Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi dokumentacionit e dorëzuar nga operatori ekonomik "Alb Building" sh.p.k, për këtë procedurë prokurimi, Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47.5 km, me vlerë totale 191,331,834.08 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë zero tetë) Lekë pa TVSH dhe REF 10913-06-24-2024 Për kriteret e kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht: 2.3.4 Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet/ punimet në objekt. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 11. "Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë: 1 (një) inxhinier Topograf, 1 (një) inxhinier Mekanik, *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 11. "Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese". Për secilin pjesëtar të stafit ndihmës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

❖ *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. 2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratore, Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 11. "Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e*

| | 81,600.00 | pa tvsh | 81,600.00 |
| Situacion Gusht 2022, datë 09.09.2022 | 264,000.00 | pa tvsh | 264,000.00 |
| | 89,100.00 | pa tvsh | 89,100.00 |
| | 61,200.00 | pa tvsh | 61,200.00 |
| Faturë tatimore nr.233/2022 datë 10.10.2022, "REJ" SHPK | 8,105,227.00 | pa tvsh | |
| Situacion Shtator 2022, datë 10.10.2022 | 1,934,137.50 | pa tvsh | 1,934,137.50 |
| | 84,600.00 | pa tvsh | 84,600.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 696,289.50 | pa tvsh | 696,289.50 |
| | 1,610,820.00 | pa tvsh | 1,610,820.00 |
| | 837,948.02 | pa tvsh | 837,948.02 |
| Procesverbal | 10.10.2022 | | |
| Situacion Shtator 2022, datë 10.10.2022 | 210,000.00 | pa tvsh | 210,000.00 |
| | 75,600.00 | pa tvsh | 75,600.00 |
| Situacion Shtator 2022, datë 10.10.2022 | 247,500.00 | pa tvsh | 247,500.00 |
| | 89,100.00 | pa tvsh | 89,100.00 |
| Faturë tatimore nr.247/2022 datë 03.11.2022, “REJ” SHPK | 8,122,413.00 | pa tvsh | |
| Situacion Tetor 2022, datë 03.11.2022 | 1,998,608.75 | pa tvsh | 1,998,608.75 |
| | 87,420.00 | pa tvsh | 87,420.00 |
| | 719,499.15 | pa tvsh | 719,499.15 |
| Procesverbal | 03.11.2022 | | |
| Situacion Tetor 2022, datë 03.11.2022 | 210,000.00 | pa tvsh | 210,000.00 |
| | 80,640.00 | pa tvsh | 80,640.00 |
| Situacion Tetor 2022, datë 03.11.2022 | 264,000.00 | pa tvsh | 264,000.00 |
| | 89,100.00 | pa tvsh | 89,100.00 |
| Faturë tatimore nr.278/2022 datë 22.12.2022, “REJ” SHPK | 8,277,028.00 | pa tvsh | |
| Situacion Nëntor 2022, datë 22.12.2022 | 1,934,137.50 | pa tvsh | 1,934,137.50 |
| | 84,600.00 | pa tvsh | 84,600.00 |
| | 696,289.50 | pa tvsh | 696,289.50 |
| Procesverbal | 22.12.2022 | | |
| Situacion Nëntor 2022, datë 22.12.2022 | 210,000.00 | pa tvsh | 210,000.00 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 75,600.00 | pa tvsh | 75,600.00 |
| Situacion Nëntor 2022, datë 22.12.2022 | 247,500.00 | pa tvsh | 247,500.00 |
| | 89,100.00 | pa tvsh | 89,100.00 |
| Faturë tatimore nr.2/2023 datë 11.01.2023, "REJ" SHPK | 8,027,460.00 | pa tvsh | |
| Situacion Dhjetor 2022, datë 11.01.2023 | 1,998,608.75 | pa tvsh | 1,998,608.75 |
| | 87,420.00 | pa tvsh | 87,420.00 |
| | 719,499.15 | pa tvsh | 719,499.15 |
| Procesverbal | 11.01.2023 | | |
| Situacion Dhjetor 2022, datë 11.01.2023 | 210,000.00 | pa tvsh | 210,000.00 |
| | 80,640.00 | pa tvsh | 80,640.00 |
| Situacion Dhjetor 2022, datë 11.01.2023 | 264,000.00 | pa tvsh | 264,000.00 |
| | 89,100.00 | pa tvsh | 89,100.00 |
| | | | |
| Fondi limit i procedurës | 191,331,834.08 | pa tvsh | |
| 30% | **57,399,550.22** | | **139,302,706.06** |

Sa më sipër, nga përllogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se ankimuesi 'Rej' SHPK me vlerën e përgjithshme prej 139,302,706.06 lekë pa TVSH të shërbimeve të ngjashme të realizuara sipas dokumenteve të paraqitura në sistemin e prokurimit elekronik e tejkalon vlerën prej 57,399,550.22 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator ekonomik për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Sa më lart, nga verifikimi i shërbimeve të realizuara dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, të paraqitura si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik 'Rej' SHPK ka kryer vlerën e kërkuar të shërbimeve të ngjashme me zërat në preventivin të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin

dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperienca të ngjashme të mëparshme, nga përllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërtimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ”Rej” SHPK ka arritur të dëshmojë se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin dhe e arrijnë vlerën prej 57,399,550.22 lekë pa TVSH, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ‘Rej’ SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Artyka II” SHPK, me arsyen se ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin:“ *2.2, kapacitetin ekonomik dhe financiar:*
*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).*” KPP vëren se,

III.3.1 Në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit, për lotin 6, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.1 është parashikuar kriteri si më poshtë:

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Artyka II” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1.Vërtetim Nr. T11485675 datë 25.09.2024, për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “ED Konstruksion” SHPK;

2. Vërtetim Nr.T11465617 datë 23.09.2024 për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “Artyka II” SHPK.

III.3.3. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik “Artyka II” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* ka deklaruar operatorin ekonomik “ED Konstruksion” SHPK si subjekt në kapacitetin e të cilit do të mbështetet, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|---|---|---|---|
| "ED-KONSTRUKSION" | K61625001I | Kapacitet Ekonomike e financiare<br><br>Aftesite teknike e profesionale ne lidhje me stafin dhe makinerit | **I.Kapaciteti ekonomik dhe financiar lidhur me piken 2.2 te DST , per plotesimin e vleres se xhiros vjetore te vitit 2021.**<br><br>**II.Kapaciteti teknik lidhur me piken 2.3.7 te DST , per plotesimin e punonjesve manovrator.**<br><br>1. me profesion drejtues I mjeteve te renda I punesuar ne shoqerine "ED-KONSTRUKSION " Sh.p.k<br>2. me profesion drejtues I mjeteve te renda I punesuar ne shoqerine "ED-KONSTRUKSION " Sh.p.k<br>**III.Kapaciteti teknik lidhur me piken 2.3.9 te DST per plotesimin e mjeteve te kerkuara**<br><br>1.**Kamion** me kapacitet mbajtes mbi 8 Ton (1 copë) -Targa Leje Qarkullimi ,Shasi<br><br>2.**Autobotë** (1copë) - Targa Leje Qarkullimi ,Shasi<br><br>3.**Miniekskavator** (1 copë), Deklaratë doganore datë 16.06.2020. |

III.3.4. Në neni 2 "*Qëllimi i ligjit*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat*

*e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.5. Në neni 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* i ndryshuar parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.6. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

III.3.7. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar parashikohet:

*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

*5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*

*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*

*7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues."*

III.3.8. Në nenin 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1.*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare1.*
*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
*a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit2, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
*b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
*c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".*
*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

---

Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[2] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

III.3.9. Në nenin 90 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

*- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*

*- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*

*- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

*- <u>Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.</u>*

*3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.*

*4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.*

*5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.*

*6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.*

*7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi."*

III.3.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në

funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.3.11. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit KPP vëren se në rastin konkret operatori ekonomik "Artyka II" SHPK ka deklaruar mbështetjen në kapacitetet e operatorit ekonomik "ED Konstruksion" SHPK referuar kjo deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në pikën B, seksioni "Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik". Gjithashtu në dokumentet e ofertës të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se subjekti mbi të cilin do të mbështetet konkretisht operatori ekonomik "ED Konstruksion" SHPK ka paraqitur në sistem formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe deklaratën e angazhimit si subjekt mbështetës i operatorit ekonomik "Artyka II" SHPK. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar është përcaktuar qartë se: *"2. <u>Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;</u>"* Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcakuar që: "4. *Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, <u>duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.</u>*" Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik "Artyka II" SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, *"Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të*

*cilëve do të mbështetet operatori ekonomik"* si subjekt mbëshshtetës operatorin ekonomik "ED Konstruksion" SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, KPP gjykon t'i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: *"4.Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor."* Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi, operatori ekonomik "Artyka II" SHPK ka ngarkuar në sistem vërtetimet Vërtetim Nr. T11485675 datë 25.09.2024, për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik "ED Konstruksion" SHPK si dhe Vërtetim Nr.T11465617 datë 23.09.2024 për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik "Artyka II" SHPK. Vlera e xhiros së deklaruar nga operator ekonomik "Ed Konstruksion" SHPK për tre vitet e fundit e përmbush kriterin e sipërcituar ndërsa vlera e xhiros së operatorit ekonomik "Artyka II" SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera nuk provon se plotëson 50% të kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. KPP konstaton se, vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet nga autoriteti kontraktor, është 191,331,834.08 lekë. Referuar parashikimit të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285, datë 19.01.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit pubik" i ndryshuar duhet që "Artyka II" SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës më sipër pra kemi 191,331,834.08 * 50% = 95,665,917.04 lekë. Mbështetur në vërtetimet e xhirove të 3 viteve të fundit për operatorin ekonomik "Artyka II" SHPK kemi:

95,665,917.04 lekë > 75,956,112 lekë (xhiro për vitin 2021);
95,665,917.04 lekë > 72,481,588 lekë (xhiro për vitin 2022);
95,665,917.04 lekë > 64,256,762 lekë (xhiro për vitin 2023);

Nga sa më sipër përllogaritur, KPP konstaton se, asnjëra vlerë e secilit vit (2021,2022,2023) të deklaruar nga operatori ekonomik "Artyka II' SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera i cili duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Në këtë kuadër, referuar të dhënave të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Artyka II" SHPK si subjekt që mbështetet në kapacitetin e operatorit ekonomik "ED Konstruksion' SHPK si edhe kërkesave për kualifikim, "*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*", pika 2.2.1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Artyka II' SHPPK në këtë procedurë prokurimi nuk është në përputhje me kriteret për kualifikim, pasi asnjëra vlerë e secilit vit (2021,2022,2023) të deklaruar nga ai si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera ku duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i

interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pavarësisht se operatori ekonomik "ED Konstruksion" SHPK si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet oepratori ekonomik "Artyka II' SHPK e përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, ky kriter do të koniderohet i papërmbushur nga oferuesi "Artyka II' SHPK si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera në këtë procedurë prokurimi sipas arsyetimit më sipër të KPP.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit "Rej' SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik "Rej" SHPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Artyka II" SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme të ankimuesit qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e operaratorit ekonomik "Artyka II" SHPK pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik "Artyka II" SHPK duke përmbushur edhe interesin e ankimuesit, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenit 4 të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19" Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "Rej" SHPK në procedurën e prokurimit "E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-10913-06-24-2024, me objekt: "- Loti 6: Mirëmbajtje me performancë: rruga K/Zëmblak - Goricë - Doganë (32.1), + Bilisht - Miras (15.4), L = 47.5 km" me fond limit 191,331,834.08 lekë pa TVSH, me datë të mbylljes për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 30.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Rej" SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së së tij ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike me datë 25.11.2024 protokolluar me tonën me nr. 3378/3 prot.,

datë 25.11.2024 dhe të kryejë rivlerësimin e procedurës duke skualifikuar operatorin ekonomik "Alb-Building" SHPK" SHPK.

4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "Rej' SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit "Artyka II" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
6. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Rej" SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Fiorent Zguro** | **Kreshnik Ternova** | **Gjergj Mersin** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2024/12/19 16:06:06 +02'00'
42fb14804f584e50b56ec66cd36ac997202412191
6055895020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*